



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:129477

Datë: 12.07.2024

Numri i dokumentit: 05932063

CP.nr.32/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen kundërpërmbarimore të kreditores Komuna e Rahovecit – Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, ndaj debitorëve B.Q, H.D, F.C, Z.F, E.D dhe Sh.K, të cilët me autorizim i përfaqëson avokati Z.H nga Prishtina, në bazë të dokumentit kundërpërmbarimor aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.47/2023 i datës 17.05.2023, vlera e kundër përmbarimit 27,747.78 euro, jashtë seance, me datë 12.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË I PASAFATSHËM propozimi për kundërpërmbarim i datës 02.05.2024 i parashtruar nga kreditori i kundërpërmbarimit Komuna e Rahovecit – Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, ndaj debitorëve të kundërpërmbarimit B.Q, H.D, F.C, Z.F, E.D dhe Sh.K, në bazë të dokumentit kundërpërmbarimor aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.47/2023 i datës 17.05.2023.

A r s y e t i m

Kreditorja e kundërpërmbarimit përmes të autorizuarit së saj, më datën 02.05.2024 ka parashtruar propozim për kundërpërmbarim ndaj debitorëve B.Q, H.D, F.C, Z.F, E.D dhe Sh.K, në bazë të dokumentit kundërpërmbarimor Aktvendim i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.47/2023 i datës 17.05.2023, vlera e kundër përmbarimit 27,747.78 euro.

Me aktvendimin Rev.nr.47/2023 të datës 17.05.2023, të cilin aktvendim kreditorja e përmbarimit sipas fletëkthesës e ka pranuar më datën 21.03.2024, “*APROVOHET si i bazuar revizioni i të paditurës: Komuna e Rahovecit – Departamenti i Shëndetësisë ashtu që Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ac.nr.404/22 i datës 28.09.2022 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Dega në Rahovec, C.nr.357/20 i datës 19.09.2021, PRISHEN dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në përsëritje të procedurës dhe vendosje*”.

Gjykata, pas vlerësimit të shkresave të lëndës gjen se propozimi për kundërpërmbarrim është i pasafatshëm.

Në nenin 54 paragrafi 1 në paragrafi 1.2 të LPP-së, shprehimisht përcaktohet se: *Debitori ka të drejtë që në të njëjtën procedurë përmbarrimore edhe pasi të ketë përfunduar përmbarrimi, të kërkojë nga Gjykata nxjerrjen e aktvendimit me të cilin i urdhërohet kreditorit që t'ia kthejë atë që e ka marrë në bazë të procedurës së përmbarrimit, në qoftë se: aktvendimi apo urdhri për përmbarrim me anë të vendimit të formës së prerë është anuluar apo ndryshuar.*

Mirëpo, gjykata, duke u bazuar në nenin 54 paragrafi 2 të LPP-së, ku përcaktohet se: *Propozimi për kundër përmbarrim nga paragrafi 1. i këtij neni mund të paraqitet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita në të cilën debitori ka marrë dijani për shkakun e kundër përmbarrimit por jo më vonë se një (1) vit nga dita e përfundimit të procedurës përmbarrimore, gjen se propozimi përkundërpërmbarrim është i pasafatshëm, pasi që aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.47/2023 i datës 17.05.2023, kreditori i kundërpërmbarrimit sipas fletëkthesës së gjykatës, e ka pranuar më datën 21.03.2024, ndërsa procedurën e kundërpërmbarrimit në këtë gjykatë e ka parashtruar më datën 02.05.2024, e që i bie që e njëjta është parashtruar 42 ditë pas pranimit të këtij aktvendimi.*

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, afati 15 ditor i paraparë në nenin 54 paragrafi 2 të LPP-së është afat subjektiv dhe ka filluar të rrjedhë në ditën kur debitori ka marrë në dijani për shkakun e përmbarrimit, ndërsa për shkakun e përmbarrimit ka marrë dijani pikërisht më datën 21.03.2024, kur edhe e ka pranuar aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.47/2023 i datës 17.05.2023.

Më tej, debitori lidhur me kërkesën e tij, mund të fillojë procedurën kontestimore, ashtu siç përcaktohet në nenin 54 paragrafi 4 i LPP-së, ku shprehimisht përcaktohet se: *Pas skadimit të afatit nga paragrafi 3. i këtij neni, debitori nuk mund të fillojë kundër përmbarrimin, por duhet të fillojë procedurën kontestimore për kërkesën e tij.*

Nga të lartë cekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
CP.nr.32/2024, data 12.07.2024

Gjyqtari
Berkan Hamza

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.